



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 390 /55 Prot.

Tiranë, më 10.10.2019

V E N D I M

Nr. 125, Datë 10.10.2019

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 17 SUBJEKTE PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET PËR PERIUDHËN 01.06.2018 DERI NË DATËN 31.12.2018, RESPEKTIVISHT BASHKITË: MALIQ, HAS, GJIROKASTËR, MALËSI E MADHE, MEMALIAJ, PËRMET, DIBËR, DEVOLL, VORË, MIRDITË, SELENICË, ELBASAN, POGRADEC, SHIJAK, KËSHILLI I QARKUT TIRANË, KËSHILLI I QARKUT SHKODËR DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE, BASHKIA TIRANË”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Auditit të Brendshëm (në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm), në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2018*”, të ushtruar në 17 subjekte, respektivisht Bashkitë: **Maliq, Has, Gjirokastër, Malësi e Madhe, Memaliaj, Përmet, Dibër, Devoll, Vorë, Mirditë, Selenicë, Elbasan, Pogradec, Shijak, Këshilli i Qarkut Tiranë, Këshilli i Qarkut Shkodër dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Tiranë**, sipas programit të auditimit nr. 390 prot., datë 28.05.2019, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të rikërkoj zbatimin e tyre, për sa vijon:

Gjatë kryerjes së këtij auditimi janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”

1-Mbi kthimin e përgjigjes të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së brenda afatit 20 ditor, hartimi i Plan veprimeve (programeve) të punës dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor dhe raportimi në këshillat bashkiak.

Nga 17 subjektet e verifikuara vetëm Bashkia **Devoll dhe Këshilli i Qarkut Shkodër nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor**, ndërsa subjektet tjera kanë kthyer përgjigje KLSH-së, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, duke hartuar edhe planet e veprimit (programet e punës), por shumica e këtyre subjekteve nuk ka raportuar në KLSH me shkrim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, me përjashtim të 3 prej tyre dhe konkretisht Bashkia Has, Bashkia Përmet dhe Bashkia Vorë. Në lidhje me raportimin në Këshillin e Njësisë, vetëm 5 nga këto subjekte kanë raportuar dhe konkretisht Bashkia Gjirokastrë, Memaliaj, Përmet, Shijak dhe Këshilli i Qarkut Shkodër, ndërsa 12 subjektet e tjera nuk kanë raportuar në Këshillat Bashkiakë. (Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet ne **Aneksin nr. 1**, bashkëlidhur këtij Vendimi)

Ndërsa realizimi i zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të tyre paraqitet:

2. MASA ORGANIZATIVE:

Masa organizative janë rekomanduar 222 masa organizative, nga të cilat, nuk janë pranuar 3 rekomandime dhe janë pranuar 219 masa organizative, prej tyre: Janë zbatuar 96 masa organizative, 95 masa organizative janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 28 masa organizative nga 8 subjekte.

*(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet ne **Aneksin nr. 2**, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

3. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 74 masa shpërblim dëmi në vlerën 124,571 mijë lekë, janë pranuar të 74 rekomandimet, janë zbatuar 14 rekomandime në vlerën 4,752 mijë lekë, janë në proces zbatimi apo proces gjyqësor 51 rekomandime në vlerën 116,208 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar nga 2 subjekte (bashkitë Memaliaj dhe Përmet) 2 rekomandime në vlerën 3,611 mijë lekë.

*(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave për shpërblim dëmi paraqitet ne **Aneksin nr. 3**, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

4. MASAT DISIPLINORE :

Masa disiplinore janë rekomanduar 129 masa disiplinore të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar 112 masa disiplinore, 2 masa disiplinore janë në proces zbatimi 2 masa disiplinore nuk janë zbatuar nga 2 subjekte 3 masa disiplinore (bashkitë Përmet dhe Pogradec). *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore dhe administrative paraqitet ne **Aneksin nr. 4**, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

5. MASAT ADMINISTRATIVE:

Masa administrative janë rekomanduar 95 masa administrative, nga të cilat janë pranuar 95 masa. Prej tyre janë zbatuar 42 masa administrative, 48 masa administrative janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 5 masa administrative nga 1 subjekt (bashkia Has).

*(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore dhe administrative paraqitet ne **Aneksin nr. 5**, bashkëlidhur këtij Vendimi).*

Ndërsa realizimi i rekomandimeve për secilin nga 17 subjektet e audituara në mënyrë të detajuar paraqitet më poshtë:

1.BASHKIA MALIQ:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Maliq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 685/7, datë 12.09.2018, protokolluar në Bashkinë Maliq me shkresën nr. 2988/2, datë 13.09.2018, ndërsa nga Bashkia Maliq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2988/3 datë 26.09.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 685/8 datë 28.09.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Maliq 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar të gjitha, prej tyre janë zbatuar plotësisht 8 masa si dhe janë në proces zbatimi 12 masa për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 9-22 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Maliq, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën 1,968,603 lekë. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 1,968,603 lekë.*

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 1,968,603 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 04.07.2019, për vlerën 30,000 lekë edhe pse janë bërë njoftimet, nuk është arkëtuar asnjë lekë, ndërsa për 2 rastet e tjera në vlerën 1,938,603 lekë ndaj 2 operatorëve ekonomikë është hapur proces gjyqësor.

Prandaj KLSH i rikërkon edhe njëherë Kryetarit të Bashkisë Maliq, zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës së rekomandimeve të pa realizuara në shumën 1,938,603 lekë, trajtuar më hollësisht në faqet 28-30 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve dhe konkretisht:

1.1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Maliq, që t’i kërkojë BOE “N.” SHPK & “V.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,619,144 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Sistemim-Asfaltim Maliq dhe Njësitë Administrative faza 1”.

2.2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Maliq, që t’i kërkojë OE “B.”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **319,459 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Kanalet sekondare në zonën Velitërnë, Zvirinë, Pîrg, Sovjan”.

3.3.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj, L. K., M. A., P. B. në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për arkëtimin e vlerës **prej 30,000 lekë.**

(trajtuar më hollësisht në faqet 28-31 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

C 1. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e vlerës **575,500** lekë, ndaj z. B. S. me detyrë ish-Kryetar i Komunës në vlerën 322,500 lekë, z. L. K. me detyrë ish-përgjegjës finance në vlerën 247,500 dhe z. B. B. me detyrë ish Sekretar i Këshillit të Komunës vlerën 5,000 lekë, nëse nuk plotësohet dokumentacioni justifikues për udhëtim e dieta.

KLSH, rikërkon zbatimin e procedurave ligjore dhe ndjekjen e të gjithave shkallëve të gjykimit për arkëtimin e shumës.

2. BASHKIA HAS:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Has rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 687/11, datë 12.09.2018, protokolluar në Bashkinë Has me shkresën nr.1708, datë 14.09.2018, ndërsa nga Bashkia Has për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 1723/1 datë 04.10.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 687/14 datë 08.10.2018. Pra përgjigja e Bashkisë Has për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Has 13 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa, (trajtuar më hollësisht në faqet 9-15 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve), për të cilat rikërkohet edhe njëherë zbatimin e tyre si më poshtë:

1.4.1. Rekomandimi: Kryetari Bashkisë Has në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a-Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë për identifikimin e dobësive dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë, duke marrë në konsideratë prioritetet e Bashkisë.

b-Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale, si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

c- Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut, të ndërtojë një plan pune me detyra të mirëpërcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës.

Të dokumentojë regjistrin qendror të riskut si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

2.8.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masat për arkëtimin e taksave të familjarëve, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, si dhe të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare ose agjentëve të tjerë (*ndërmarrja e ujësjellësit*), për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara për vlerën **9,800,000 lekë**.

3.9.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Has, të marrë masat për evidentimin e të gjitha objekteve të ndërtuara në territorin e Bashkisë Has dhe në rast të evidentimit të objekteve pa leje të ndërmerren hapat ligjorë.

Për 7 rastet e konstatuara me ndërtim pa leje, IMTV të vazhdojë procedurat për aplikimin e gjobës për vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, në zbatim të

ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 52, *Kundërvajtjet administrative*, shkronja (e).

Për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv dhe të përllogariten kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", konkretisht për personat: H. L., A. M., N. N., B. D., H. K., H. H. dhe J. I. C..

4.13. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Has për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2016-31.12.2017, dërguar me shkresën nr. 687/11, datë 12.09.2018, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".

B-I. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Has*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **16,717,188 lekë**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 16,717,188 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi në Bashkinë Has, janë rekomanduar 9 masa me vlerë 16,717,188 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.06.2019, janë arkëtuar 1,592,547 lekë, ndërsa janë nisur njoftimet për 3 rekomandime për shumën 3,848,972 lekë për të cilat nuk kanë filluar ende arkëtimet, për të cilën KLSH rikërkon zbatimin e procedurave ligjore dhe ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjyqimit për arkëtimin e saj.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH i rikërkon Bashkisë Has, zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit deri në arkëtimin e plotë të dëmit ekonomik, (trajtuar më hollësisht në faqet 16-22 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

B/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA NË SHUMËN 24,203,739 LEKË)

Janë në proces zbatimi 2 rekomandime dhe nuk është zbatuar rekomandimi nr. 3, për të cilën rikërkojmë zbatimin e këtij rekomandimi si më poshtë:

1.3.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masat për arkëtimin e taksave të familjarëve, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018" pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, si dhe të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare ose agjentëve të tjerë (ndërmarrja e ujës-jellësit), për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara për **vlerën 9,800,000 lekë**.

C/2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT).

Referuar shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratave të punëve publike, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenin 15 e 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe

përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a), të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtime të kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i rikërkon** Kryetarit të Bashkisë Has, në mungesë të Kryeinspektorit të IMTV, t’i kërkojë **Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes Territoriale (IKMT)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës dhe 1 (një) kolaudator, si më poshtë:**

1-z.I. D., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve,

2-z.N. Xh., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve,

3-z.D. Xh., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

(trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

3.BASHKIA GJIROKASTËR

KLSH ka dërguar në Bashkinë Gjirokastrë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 684/9, datë 11.09.2018, ndërsa nga Bashkia Gjirokastrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 6389/1, datë 15.10.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.684/17 datë 18.10.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Gjirokastrë 7 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, prej tyre janë zbatuar plotësisht 3 masa, nuk ka masa organizative të pazbatuara, janë në proces zbatimi 4 masa dhe për të cilat kërkojmë vazhdimin e procedurave deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve *(trajtuar më hollësisht në faqet 8 -13 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH*, **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **7,158,793 lekë**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 7,158,793 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi në Bashkinë Gjirokastrë, janë rekomanduar 16 masa me vlerë 7,158,793 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.12.2018, janë arkëtuar 115,680 lekë, ndërsa shuma 7,043,113 lekë nuk është arkëtuar, nga e cila për 14 rekomandime janë nisur njoftimet por ende nuk kanë filluar arkëtimet në vlerën 3,268,722 lekë, ndërsa 1 rekomandim për vlerën 3,471,891 lekë është në proces gjyqësor.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH i rikërkon Bashkisë Gjirokastrë, zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e plotë të dëmit ekonomik *(trajtuar më hollësisht në faqet 13-27 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).*

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) (në lidhje me Bashkinë Gjirokastrë).

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.08.2015 deri më 31.12.2017, mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010

“Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **4 punonjësve**, për procedurat e prokurimit.

Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr. 113, datë 26.11.2018 përcjellë në Bashkinë Gjirokastrë dhe KLSH duke vendosur masa dënim me gjobë për 3 persona në vlerën totale prej **1,500,000 lekë**. Çështja është në proces gjyqësor me Aktpadinë datë 14.12.2018.

Pavarësisht nga kjo, **KLSH i kërkon** Bashkisë Gjirokastrë, Drejtorisë Juridike të përfaqësohet në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor, të ndërmarrë gjithë hapat ligjore për arkëtimin e 3 gjobave për vlerën **1,500,000 lekë**, në se nuk paguhen në mënyrë vullnetare për 3 personat të llogaritë kamat vonesat mbi masën e gjobës.

C.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014, datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **KLSH i ka rekomanduar** Kryetarit të **Bashkisë Gjirokastrë** t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Gjirokastrë, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, dhe **të vendosë masë administrative “Dënimin me gjobë”, për 3 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh.**

Nga verifikimi rezultoi se nga IMTV Bashkia Gjirokastrë deri në momentin e verifikimit nga KLSH, nuk ishin nxjerr vendimet e gjobave nga IMTV dhe vetëm pas ndërhyrjes së audituesve të KLSH, IMTV nxori vendimet e gjobave për 4 persona në shumën totale **prej 650,000 lekë**, por ende nuk ka filluar procesi i arkëtimit, **për këtë KLSH i kërkon** Bashkisë Gjirokastrë, Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë Financës që të kryejë kontabilizimin e vlerës gjobave dhe ndërmarrë gjithë hapat ligjore për arkëtimin e 4 gjobave **për vlerën 650,000 lekë, si më poshtë:**

1.T. S. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.30, datë 24.06.2019 është gjobitur në shumën 50.000 lekë.

2.E. M. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.31, datë 24.06.2019 është gjobitur në shumën 50.000 lekë.

3.D. Q. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.29, datë 24.06.2019 është gjobitur në shumën 50.000 lekë.

4.G. S. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.26, datë 13.06.2019 është gjobitur në shumën 500.000 lekë.

(trajtuar më hollësisht në faqet 35-38 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

4.BASHKIA MALËSI E MADHE

KLSH ka dërguar në Bashkinë Malësi e Madhe rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.688/7, datë 13.09.2018, protokolluar në Bashkinë Malësi e Madhe me shkresën nr.5913, datë 17.09.2018, ndërsa nga Bashkia Malësi e Madhe për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 6342 datë 02.10.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 688/12 datë 08.10.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Malësi e Madhe 18 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe 5 masa organizative nuk janë zbatuar për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon: (trajtuar më hollësisht në faqet 9-19 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

1.2.1 Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të punojë për implementimin e kërkesave të ligjit.

2.8.1. Rekomandim: Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa që, para hedhjes së objekteve në sistemin elektronik të prokurimeve, të ndiqen procedurat e marrjes së lejes së ndërtimi, në mënyrë që objektet të realizohen sipas projektit dhe preventivit të miratuar.

3.15.1. Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe nëpërmjet strukturave të saj si Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me zyrën Juridike dhe sektorin e menaxhimit të pyjeve e kullotave, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive koncensionare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullosor.

4.16.1.Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjiellës SHA Malësi e Madhe, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, bazuar në legjislacionin në fuqi.

5.18.1.Rekomandimi: Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Malësi e Madhe për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2016 – 31.12.2017, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmasimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 të nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b)-Të drejtat e KLSH- së, **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën 3,058,960. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e **vlerës 3,058,960 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se, për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 3,084,710 lekë. Është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.06.2019, janë arkëtuar 25,750 lekë, ndërsa shuma 3,058,960 lekë nuk është arkëtuar, nga e cila vlera 208,500 lekë është në proces arkëtimi, ndërsa janë nisur njoftimet për 2 rekomandime për vlerën 2,801,210 lekë por ende nuk kanë filluar arkëtimet.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH i rikërkon Bashkisë Malësi e Madhe, zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e plotë të dëmit ekonomik (Trajtuar më hollësisht në faqet 19-22 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

B/II. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë (ish Komuna Gruemirë dhe ish-Komuna Qendër), u konstatua se janë paguar me vendim gjykate për largim të padrejtë të punonjësve nga puna, gjithsej për vlerën **353,753 lekë**. Për këtë proces gjyqësor të humbur, Bashkia Malësi e Madhe nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe të marrë masa ndaj personave përgjegjës, veprim në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, pika 6.1 ”Vendimet gjyqësore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet 38-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1. Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe të analizojë të gjitha proceset gjyqësore të cilat kanë sjellë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësishë ligjore ndaj personave shkaktarë të gjendjes, si dhe të ndjekin të gjitha shkallët e gjyqësorit.

B/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1.4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Malësi e Madhe, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,495,000 lekë**, detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave sipas aneksit nr.5/3 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Malësi e Madhe, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,030,000 lekë**, për mos aplikim tarife për subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi me fonde private, sipas aneksit nr.5/4 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1. Rekomandimi:Nga Bashkia Malësi e Madhe, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **280,380 lekë**, detyrimet për taksat dhe tarifave vendore si taksa trualli, taksa ndërtesë, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifave të gjelbërimit për qëllime biznesi, sipas aneksit nr.5/5 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

C. MASAT ADMINISTRATIVE:

c.1.Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik (Bashkia Malësi e Madhe).

I. Referuar parregullsi dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 6 punonjësve.**

Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 119, datë 19.12.2018, ka vendosur masa dënim me gjobë për 6 persona në vlerën në total prej 1.900.000 lekë. Nga Bashkia Malësi e Madhe me shkresat nr. 117,117/1,117/2,118,118/1,119, datë 08.01.2019 janë njoftuar personat dhe janë kontabilizuar veprimet. Prej tyre deri më datën e verifikimit është arkëtuar plotësisht 1 gjobë në shumën 300,000 lekë, janë arkëtuar pjesërisht 5 gjoba në vlerën 644,300 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar **nga 5 persona shuma prej 955,700 lekë**. Me vendimin nr. 911, datë 19.12.2018, APP ka rekomanduar gjithashtu kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, marrjen e masave për 4 punonjës. Nga verifikimi rezulton se për 3 prej tyre është marrë masa vërejtje, ndërsa për 1 person nuk është marrë masë, pasi e ka përfunduar marrëdhënien e punës në Bashkinë Malësi e Madhe.

KLSH kërkon që të vazhdojnë ndalesat për 5 vendimet e gjobave të vendosura nga APP në Bashkinë Malësi e Madhe dhe të mbetura pa u arkëtuar deri më datën e verifikimit për vlerën 955,700 lekë si më poshtë:

1.E. S., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të NJP, me vendimin e APP nr.119, datë 19.12.2018 është gjobitur në shumën 500.000 lekë. Deri më datën 30.06.2019 është arkëtuar shuma prej 150,000 lekë, mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 350,000 lekë.

2.G. I., me detyrë Specialist i Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të NJP, me vendimin e APP nr.119, datë 19.12.2018 është gjobitur në shumën 250.000 lekë. Deri më datën 30.06.2019 është arkëtuar shuma prej 112,000 lekë, mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 138,000 lekë.

Shtesa nga APP

3-V. Z., me detyrë specialiste buxheti, me vendimin e APP nr.119 datë 19.12.2018 është gjobitur në shumën 300.000 lekë. Deri më datën 30.06.2019 është arkëtuar shuma prej 111,300 lekë, mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 188,700 lekë.

4-F. Gj., me detyrë specialist IVMT, me vendimin e APP nr.119 datë 19.12.2018 është gjobitur në shumën 200.000 lekë. Deri më datën 30.06.2019 është arkëtuar shuma prej 109,700 lekë duke mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 90,300 lekë.

5-F. C., me detyrë përgjegjës tatim-taksa, me vendimin e APP nr.119 datë 19.12.2018 është gjobitur në shumën 350.000 lekë. Deri më datën e verifikimit është arkëtuar shuma prej 161,300 lekë duke mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 188,700 lekë.

D.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMTV) Bashkia Malësi e Madhe.

Referuar shkëlqet të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkëlqet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh, si më poshtë:**

1. V. T. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2.E. M. përfaqësues ligjor i subjektit “ARENA MK” sh.p.k, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve

3. R. St., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Nga verifikimi rezultoi se pas auditimit të kryer nga KLSH në këtë subjekt dhe rekomandimeve të lëna dhe pasqyruara në Projekt Raportin e Auditimit, Kryeinspektori i IMTV Bashkia Malësi e Madhe ka marra masat, duke vendosur gjobat e kërkuara nga audituesit e KLSH për 2 mbikëqyrësit z. **V. T. dhe z. E. M. në shumën 50,000 lekë si dhe kolaudatorin z. **R. S.** në shumën 50,000 lekë. Në lidhje me masën e gjobës ndaj kolaudatorit, KLSH konstaton se ajo nuk është vendosur në përputhje me nenin 15 të ligjit me nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, i cili përcakton se për shkëlqet e nenit 12, të këtij ligji vendoset si dënim kryesor masa e gjobës nga 500,000 deri në 5,000,000 lekë dhe jo siç e ka vendosur IMTV në vlerën 50.000 lekë. **KLSH rikërkon që ndaj kolaudatorit z. R. S. të merret masa e gjobës** në përputhje me kërkesat e ligjit të mësipërm dhe të vazhdojnë procedurat ligjore për arkëtimin e gjobave. (trajtuar më hollësisht në faqet 31-33 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).**

5. BASHKIA MEMALIAJ

KLSH ka dërguar në Bashkinë Memaliaj rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 686/9, datë 10.09.2018, protokolluar në Bashkinë Memaliaj me shkresën nr. 947/2, datë 11.09.2018,

ndërsa nga Bashkia Memaliaj për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 947/5 datë 20.09.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 686/13 datë 27.09.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Memaliaj 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 7 masa, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

(trajtuar më hollësisht në faqet 8-14 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

1.4.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës së Bashkisë Memaliaj të merren masa për saktësimin e vlerave të ujësjellësve dhe të rrjeteve dytësore KUZ transferuar në Ndërmarrjen e Ujësjellës- Kanalizime Tepelenë për sa nuk rakordon vlera 15,263,492 lekë si diferencë midis vlerës së transferuar dhe pasqyrës financiare nr. 6, "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (Vlera) bruto".

2.6.1 Rekomandimi: Të sistemohen pozicionet financiare të gabuara të trashëguar nga ish – Komunitat dhe nga bashkia të mbartur në bilancin e vitit 2017, të anulohet teprica e trashëguar në llogarinë nr. 468 "Debitorë" për vlerën 63,439,363 lekë duke debituar llogarinë nr. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme". Të kreditohet llogaria nr. 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor) dhe të debitohet llogaria nr. 468 "Debitorë në persona" për vlerën 31,126,099 lekë. Të debitohet llogaria nr. 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor" dhe të kreditohet llogari nr. 475 "të ardhura për tu arkëtuar" në vlerën 31,126,099. Të ndryshohet rezultati i vitit 2017, për sa është paraqitur më i lartë për pozicionin financiar të llogarisë nr. 466 "Vlera në ruajtje" për shumën 11,077,297 lekë.

3.11.1 Rekomandimi: Nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të merren masa për krijimin e regjistrit të pronave dhe të vlerësohen me ekspert trojet dhe ndërtesat e kaluara në pronësi të Bashkisë Memaliaj dhe të ish-komunave për përfshirjen e tyre në bilancin kontabël dhe regjistrimin në ZVRPP.

4.12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë, identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtë të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e bashkisë në vijimësi.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale, si objektivi prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) – *Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën 1,565,757 lekë.*

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 1,565,757 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 10.06.2019, janë arkëtuar 173,015 lekë, ndërsa nuk është nisur njoftimi për 1 rekomandim në shumën 1,392,742 lekë për të cilën KLSH rikërkon zbatimin e rekomandimit si më poshtë:

1.3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,392,742 pa tvsh** nga BOE “C.” shpk & “V.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 314/38 dt.12.07.2016 me objekt “*Ansambli Arkitektonik i Sheshit Minatori Memaliaj*”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktik (*Trajtuar më hollësisht në faqet 14-16 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve*).

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 i ndryshuar, Kreu III, nenin 15 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **KLSH rikërkon që aktet e konstatimit të KLSH, mbajtur me 2 mbikëqyrësit e punimeve të dërgohen për kompetencë, Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si më poshtë:**

1.1.F. B., përfaqësues i “H.” shpk nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në masën 300,000 lekë.

1.2.E. M., përfaqësues i “A.” shpk nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në masën 50,000 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-19 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve*).

6. BASHKIA PËRMET

KLSH ka dërguar në Bashkinë Përmet rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.683/6, datë 11.09.2018, protokolluar në Bashkinë Përmet me shkresën nr.2242, datë 13.09.2018, ndërsa nga Bashkia Përmet për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.2242/1 datë 02.10.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 683/8 datë 04.10.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Përmet 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.15.1 Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa që për 2 mjetet e blera të hartohet kontrata e shitjes para noterit publik, sipas Fletë hyrjes së magazinës nr. 92, datë 13.10.2017, respektivisht, Mjetin Tip Fadromë me vlerë 3,000,000 lekë dhe Kamion vetëshkarkues me vinç me vlerë 1,992,000 lekë, me qëllim që mjetet të regjistrohen në pronësi të Bashkisë Përmet, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “*Kodi Civil i R.SH*” me ndryshime, respektivisht neni 710 “*Detyrimet e shitësit në shitjen e pasurisë së luajtshme*”, pika 2,dhe Neni 747 “*Kalimi i pronësisë*”, “*...Kur objekti i shitjes janë sende të paluajtshme ose sende të luajtshme të regjistruara, zbatohen dispozitat mbi regjistrimin.*”

2.20.1 Rekomandimi: Bashkia Përmet të riprogramojë punën dhe të marrë masa konkrete për zbatimin e rekomandimeve të përealizuara dërguar nga KLSH me shkresën nr. 1113/108 datë 31.01.2018 dhe trajtuar më hollësisht në Akt Verifikimin nr. 1, datë 20.07.2018 “*Për zbatimin e rekomandimeve*” dhe faqet 8-21 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

4. MASA ADMINISTRATIVE

Me Vendimin nr. 90, datë 17.10.2016, APP ka vendosur dënim me gjobë për 6 anëtarët e KVO në vlerën **480,000 lekë**. Me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. vendimi 80-2016-5547 datë 22.11.2016, është vendosur “*Rrëzimi i kërkesë padisë paraqitur nga punonjësit e bashkisë Përmet, si i pabazuar në ligj dhe prova*”. Bazuar në nenin 45, të ligjit nr.

49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, është i paankimueshëm. Nga verifikimi rezultoi se nga ana e Sektorit Financës bashkia Përmet, nuk kishte filluar ekzekutimi i vendimeve të gjobave (ndalesat nga paga). Aktualisht në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Përmet ka qenë vetëm zj. M. F. (H.), për të cilën nuk ka filluar mbajtja e vlerës së gjobës.

Nga ana e Drejtorisë Juridike nuk janë marrë masa për arkëtimin e 6 gjobave të vendosura me Vendimin e APP nr. 90, datë 17.10.2016 për dënim me gjobë për 6 anëtarët KVO në vlerën **480,000 lekë**, ku sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. vendimi 80-2016-5547 datë 22.11.2016 dhe nenin 45, të ligjit nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, vendimi është i paankimueshëm.

Rekomandimi: Bazuar në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30-arkëtimi i të ardhurave, pika 1 shkronja b- vendimet e gjykatës ka marrë formën e prerë, ndaj tyre, sipas pikës 3 duhet të paguhet 2 përqind kamat vonesë në muaj të masës gjobës.

Sa sipër nga Drejtoria Juridike dhe Sektori i Financës Bashkia Përmet të kryhen kontabilizimet dhe të ndiqen procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës prej **480,000 lekë** për 6 personat si më poshtë:

1.M. F. (H.) në cilësinë e Juristes, është gjobitur në **vlerën 80,000 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri me dt.29.06.2019 nuk është arkëtuar asnjë lekë (Vendimi i gjobës nuk është kontabilizuar)

2.E. N., Specialist Shërbimesh, është gjobitur në **vlerën 80,000 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri me dt.28.06.2019 nuk është arkëtuar asnjë lekë (Vendimi i gjobës nuk është kontabilizuar)

3.I. Sh., Drejtores e Financës, është gjobitur në **vlerën 80,000 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri me dt.28.06.2019 nuk është arkëtuar asnjë lekë (Vendimi i gjobës nuk është kontabilizuar)

4.P. L., në cilësinë e anëtarit të KVO, është gjobitur në **vlerën 80,000 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri me dt.28.06.2019 nuk është arkëtuar asnjë lekë (Vendimi i gjobës nuk është kontabilizuar)

5.E. M., në cilësinë e anëtarit të KVO, është gjobitur në **vlerën 80,000 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri me dt.28.06.2019 nuk është arkëtuar asnjë lekë (Vendimi i gjobës nuk është kontabilizuar)

6.V. P., në cilësinë e anëtarit të KVO, është gjobitur në **vlerën 80,000 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri me dt.28.06.2019 nuk është arkëtuar asnjë lekë (Vendimi i gjobës nuk është kontabilizuar).

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Përmet*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimin, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **5,355,513 lekë**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 5,355,513 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 7 masa me vlerë 5,355,513 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar vlera 2,488,687lekë, vlera 2,866,826 është kontabilizuar në ditë jashtë kontabilitetit. Deri me datë 01.06.2019, janë arkëtuar 644,319 lekë, është në proces arkëtimi 1 rekomandim në vlerën 2,222,507 lekë, janë nisur njoftimet për 4 rekomandime në vlerën 2,226,387 lekë, ndërsa shuma 4,711,194 lekë nuk është arkëtuar.

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

2.2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Përmet, që t’i kërkojë BOE “R.” SHPK & “V.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimin arkëtimin e shumës **1,060,822 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Tefta Tashko Koço, Elena Gjika, Vasil Papallopulo”.

3.3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Përmet, që t’i kërkojë OE “M.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimin arkëtimin e

shumës **491,785** lekë pa TVSH, të përfitur tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrugëve të brendshme të fshatit Piskove”.

4.4.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Përmet, që t’i kërkojë (BOE) “E.” SHPK & “A.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **51,180 lekë pa TVSH**, të përfitur më tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Kanali Ujitës i Çarshovës”.

5.7.1 Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa dhe t’i kërkojë hartuesit të preventivitetit **ing. D. M.**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **617,600 lekë pa TVSH**, pasi është preventivuar dhe rritur më tepër fond limit, për objektin: “*Kanali ujitës i Çarshovës*”, si pasojë e rritjes të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 21-25 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve*).

7. BASHKIA DIBËR

KLSH ka dërguar në Bashkinë Dibër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 545/11, datë 11.09.2018, ndërsa nga Bashkia Dibër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.3099/4 datë 14.11.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.545/15 datë 19.11.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Dibër 13 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, dhe nuk janë zbatuar 2 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon: (*trajtuar më hollësisht në faqet 8-21 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve*).

1.9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masa për zbatimin e reformës administrative, duke krijuar një strukturë organizative efëçente në referim të numrit të përgjithshëm të banorëve, me qëllim ushtrimin me efektivitet dhe ekonomicitet të funksioneve bazë të njësisë dhe veçanërisht realizimin e të ardhurave nga sistemi i taksapaguesve dhe për një shpërndarje sa më racionale të fondeve për investime.

2.12.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, të realizoj në mënyrë të plotë e profesionale procesin e vlerësimit të kërkesës për lëshimin e titullit të pronësisë mbi tokë bujqësore për H. M., procesi i cili duhet mbështetur në kriteret ligjore dhe afat kohore të përcaktuara ligjërisht, duke u referuar plotësisht në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi si dhe korrespondencat e krijuar me institucione të tjera lidhur me kalimin e tokës bujqësore në përdorim për qëllime bujqësore, si përfitues të ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “*Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, të cilët banojnë realisht në fshat dhe nuk janë sistemuar me punë e strehim në qytet a qendra të banuara*”, sipas përcaktimit të pikës 2/paragraf i fundit të VKM nr. 255, datë 02.08.1991.

Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Sektorit të Administrimit të Pronave dhe Strehimit, të përgatisë dhe paraqes në Këshillin Bashkiak projektvendimin përkatës për të ndjerin H. M., me qëllim vlerësimin dhe shprehjen nga organi i ngarkuar me ligj (KB) me vendim (miratimi apo refuzimi) të plotësisht të titullit të pronësisë.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, të realizoj në mënyrë të plotë e profesionale procesin e vlerësimit të kërkesës për lëshimin e titullit të pronësisë mbi tokë bujqësore për H. M., procesi i cili duhet mbështetur në kriteret ligjore dhe afat kohore të përcaktuara ligjërisht, duke u referuar plotësisht në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi si dhe korrespondencat e krijuar me institucione të tjera lidhur me kalimin e tokës bujqësore në përdorim për qëllime bujqësore, si përfitues të ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “*Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, të cilët banojnë realisht në fshat dhe*

nuk janë sistemuar me punë e strehim në qytet a qendra të banuara”, sipas përcaktimit të pikës 2/paragraf i fundit të VKM nr. 255, datë 02.08.1991.

Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Sektorit të Administrimit të Pronave dhe Strehimit, të përgatisë dhe paraqes në Këshillin Bashkiak projektvendimin përkatës për të ndjerin H. M., me qëllim vlerësimin dhe shprehjen nga organi i ngarkuar me ligj (KB) me vendim (miratimi apo refuzimi) të plotësisimit të titullit të pronësisë.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Për kërkesën e z. H. H. M. ku kërkon pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi për sipërfaqen prej 10015m² për pasurinë nr. 538 zona kadastrale 2592, me adresë fshati Maqellarë, Bashkia Dibër sqaron se: ju bëjmë me dije se korrespondenca zyrtare dhe procedura e ndjekur për këtë kërkesë ju është dërguar zyrtarisht nga ana jonë me shkresën tone nr. 5107/3 prot. datë 14.01.2019. Gjithashtu ju informojmë se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me shkresën e tyre nr. 1099 prot. datë 05.02.2019 na informon se ka regjistruar procedim penal, për nevoja të veprimeve hetimore që po kryhen në kuadër të këtij procedimi ka kërkuar fotokopje të njësuar me origjinalin të dosjes së plotë që lidhet me trajtimin me tokë bujqësore të shtetasit H. H. M.. Në kthim përgjigje me shkresën tonë nr. 503 / 1 prot. datë 11.02.2019, Bashkia Dibër sqaron se ju kemi vënë në dispozicion fotokopjen të njëjësuar me origjinalin të dokumentacionit të plotë si dhe korrespondencën zyrtare të bërë nga Bashkia Dibër me institucionet përkatëse për trajtimin e kërkesës të shtetasit H. H. M..*

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në vijim të shkresës nr.1331 prot, datë 30.11.2018, të dërguar nga qytetari H. H. M., dhe protokolluar me nr 133/1, datë 30.11.2018 në përmbajtje të tagrit ligjor të përcaktuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “ Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka ushtruar auditim në Bashkinë Dibër lidhur me zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH .

Përsa i përket rekomandimit nr.12 me karakter organizativ (për pajisjen me Aktin e Marrjes së Tokës në pronësi të z. H. H. M), duke administruar të gjithë dokumentacionin e administruar nga Bashkia Dibër, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Këshillit Bashkiak, në përfundim të cilit rezultoi se:

Bashkia Dibër, me shkresën nr.3099 prot, datë 13.09.2018 ka administruar, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet e KLSH-së, dërguar me shkresën nr.545//11 prot, datë 11.09.2018, akte të miratuara me Vendimin nr.121. datë 06.09.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, Bashkia Dibër, Kryetari ka miratuar programin e punës datë 04.10.2018.

Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 116, datë 25.09.2018” Për pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi”, ka miratuar kërkesën e z. H. H. M sipas dokumentacionit bashkëlidhur vendimit, ka ngarkuar për zbatim Sektorin e Administrimit të Pronave dhe Strehimit, VKB është dërguar institucionit të Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 4256 prot, datë 08.10.2018.

Me shkresën nr.1577/3 prot, datë 19.10.2018, Prefekti i Qarkut ka përcjellë prononcimin përfundimtar rreth vendimit nr.116 datë 25.09.2018 duke e konsideruar si akt administrative i cili bën pjesë në kategorinë e akteve absolutisht të pavlefshme.

Këshilli Bashkiak, në referim të kompetencave të dhëna nga ligji nr.139 “ për vetëqeverisjen vendore” , pas kthimit nga Prefekti të vendimit nr.116, datë 25.09.2018 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me vendimin nr.112, datë 24.10.2018 “ Për pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi”, duke ngarkuar për zbatim Sektorin e Administrimit të Pronave dhe Strehimit.

Qytetari H. M. me ankesën për pajisje me AMTP , bazuar në vendimet e Këshillit Bashkiak nr 116, datë 25.09.2018 dhe nr 122. Datë 24.10.2018 me anë të të cilit kërkohet zbatimi i këtij vendimi nga Zyra e Administrimit të Pronave dhe Strehimit, kërkesë të cilës me datë 23.11.2018 me nr 4671/1 prot, bashkia Dibër i është përgjigjur negativisht.

Sa më sipër, KLSH në referim të dispozitave ligjore të sipërcituara, *i rikërkon* Bashkisë Dibër veçanërisht Sektorit të Administrimit të Pronave dhe Strehimit si dhe Prefektit të Qarkut Dibër, të mos pengojnë qytetarin në të drejtën e tij për tu pajisur me AMTP, duke zbatuar njëkohësisht rekomandimin në të kundërt KLSH, **do ti drejtohet organeve gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Dibër*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **71,835,638 lekë. Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 71,835,638 lekë.**

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 9 masa me vlerë 71,835,638 lekë, është pranuar e gjithë vlera nga të cilat janë hartuar padi gjyqësore për 6 rekomandime në vlerën 15,179,919 lekë si dhe janë nisur njoftimet për 3 rekomandime ndaj 4 personave për vlerën 56,655,719 lekë por ende nuk kanë filluar arkëtimet.

Për rekomandimet “Masa shpërblim dëmi” respektivisht rekomandimet nr. 1.1, 2.1, 3.1, b bbbbbb 4.1, 5.1, 6.1, 9.1 të vijojë procesi gjyqësor për kërkimin e masës shpërblim dëmi për të gjitha subjektet për të cilat janë përgatitur paditë dhe dorëzuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (Trajtuar më hollësisht në faqet 21-29 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

Referuar parregullsi dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **12 punonjësve dhe ish-punonjës.**

Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr.4, datë 16.01.2019 përcjellë për në Bashkinë Dibër dhe KLSH-në, ka vendosur masa dënim me gjobë për 15 persona në vlerën në total prej **3,020,000 lekë.** Nga Bashkia Dibër me shkresën nr. 225/1 datë 23.01.2019 janë njoftuar personat përgjegjës. Prej tyre deri më datën e verifikimit ka mbetur pa u arkëtuar nga 15 persona shuma prej **3,020,000 lekë**, për të cilat **KLSH kërkon ndjekjen e shkallëve të gjykimit për 15 personat në vlerën 3,020,000 lekë**, si më poshtë:

- 1.E.S., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 300.000 lekë.
- 2.U. M., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur në shumën 400.000 lekë.
- 3.J. B., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 300.000 lekë.
- 4.F. K., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 200.000 lekë.
- 5.B. D., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 120.000 lekë.
- 6.E. Sh., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 150.000 lekë.
- 7.I. R., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 50.000 lekë.
- 8.F. M., në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, është gjobitur me 50.000 lekë.
- 9.L. C., në cilësinë e Kryetarit të KVO, është gjobitur në shumën 400.000 lekë.
- 10.K. R., në cilësinë e Anëtarit të KVO, është gjobitur në shumën 400.000 lekë.
- 11.K. S., në cilësinë e Anëtarit të KVO, është gjobitur në shumën 300.000 lekë.

12.Z. Gj., në cilësinë e Anëtarit të KVO, është gjobitur në shumën 50.000 lekë.

13-M. R., ish kryetari i bashkisë Dibër, është gjobitur në shumën 100.000 lekë.

14-A. B., me vendimin e APP nr.4 datë 16.01.2019 është gjobitur në shumën 100.000 lekë.

15-R. K., me vendimin e APP nr.4 datë 16.01.2019 është gjobitur në shumën 100.000 lekë

(trajtuar më hollësisht në faqet 38-40 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

8. BASHKIA DEVOLL (Auditim tematik)

KLSH ka dërguar në Bashkinë Devoll rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.935/7, datë 27.11.2018, protokolluar në Bashkinë Devoll me shkresën nr.2305/3, datë 04.12.2018, ndërsa nga Bashkia Devoll për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk ka kthyer përgjigje**. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Devoll 3 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë, nuk ka masa organizative të pazbatuara dhe janë në proces zbatimi 2 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre *(trajtuar më hollësisht në faqet 8-9 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka kërkuar Kryetarin të Bashkisë Devoll*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 366,955 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë 366,935 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.06.2019, nuk ishin nisur njoftimet për 2 rekomandime, pasi Bashkia Devoll pretendon që nga garancia e punimeve do t’u kryejë ndalesat për 2 subjektet në vlerën 366,935 lekë.

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi paraqiten si më poshtë:

1.1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Devoll, që t’i kërkojë OE “S.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës **132,935 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës nr.35/38, prot., datë 14.08.2017, me objekt: “*Ndërtimi i pilave të urës tip “BAILY” në lumin Devoll, njësia administrative Miras*”.

2.2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Devoll, që t’i kërkojë BOE “A.” SHPK & “S.” SHPK përfaqësues nga OE “A.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës **234,000 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës nr.1144/17, prot., datë 10.07.2018, me objekt: “*Rehabilitimi i kanalit ujitës të fushës së Bilishtit, Kanali Bracanj - Vishocicë*”(trajtuar më hollësisht në faqet 9-11 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

C. MASA ADMINISTRATIVE

c.1-Për Agjencinë e prokurimit publik, Bashkia Devoll

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH i ka **rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me të metat e mangësitë e konstatuara, 11 punonjësve.**

Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr. 18, datë 1.02.2019 përcjellë për në Bashkinë Devoll dhe KLSH-në me shkresën nr.10525/7 datë 21.02.2019, ka vendosur masën dënim me gjobë për 11 persona në vlerën total prej 860,000 lekë. Nga Bashkia Devoll me shkresën nr. 708/1/2/3 datë 11.03.2019 janë njoftuar personat dhe nuk janë kontabilizuar veprimet, pasi janë në proces gjyqësor, për të cilën KLSH kërkon ndjekjen e shkallëve të gjykimit dhe përfundim të procesit gjyqësor kërkon ndjekjen e procedurave ligjor për arkëtimin e tyre dhe kontabilizimin e vlerës për 11 persona në vlerën 860,000 lekë, si më poshtë:

- 1.D. Z., në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 100,000 lekë.
- 2.V. M., në cilësinë e ant. të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 100,000 lekë.
- 3.A. Xh., në cilësinë e ant. të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 100,000 lekë
- 4.J. P., në cilësinë e ant. të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 100,000 lekë
- 5.A. N., në cilësinë e ant. të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 100,000 lekë
- 6.B. K., në cilësinë e anëtarit të KVO është gjobitur në shumën 70,000 lekë.
- 7.O. Zh., në cilësinë e anëtarit të KVO është gjobitur në shumën 70,000 lekë.
- 8.E. Sh., në cilësinë e anëtarit të KVO është gjobitur në shumën 70,000 lekë.
- 9.E. A., në cilësinë e ant. të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 50,000 lekë.
- 10.V. B., në cilësinë e ant. të komisionit të hartimit DST, është gjobitur me 50,000 lekë.
- 11.R. H., në cilësinë e ant. të komis. të hartimit DST, është gjobitur me 50,000 lekë.

c.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Devoll (IMTV)

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, ndryshuar me Ligjin Nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH i ka kërkuar Kryetarit të Bashkisë Devoll, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator, si më poshtë:

1. Z. G. P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, drejtues ligjor dhe teknik i shoqërisë “H.” SHPK dhe licencë MK. 2720/5, datë 24.07.2017, për shkeljet e konstatuara në 2 objektet.
2. Z. F. N., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, në objektin: “Ndërtimi i pilave të urës tip “BAILY” në lumin Devoll, njësia administrative Miras” .

Nga verifikimi rezultoi se: IMTV Bashkia Devoll, me shkresën nr. 3290. Dt.08.10.2019 pas dërgimit të Projekt Raportit të Auditimit për zbatimin e rekomandimeve, mori masat administrative ndaj 2 personave të mësipërm, konkretisht ndaj z. G. P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën 50,000 lekë sipas vendimit me nr. 10, datë 09.09.2019, si dhe ndaj z. F. N., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, gjobë në masën 50,000 lekë sipas vendimit nr. 11, datë 09.09.2019 të Kryeinspektorit të IMTV.

Bashkia Devoll, të vijojë me zbatimin në rrugë administrative dhe ligjore për arkëtimin e këtyre gjobave në shumën 100,000 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 12-14 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

9. BASHKIA VORË

KLSH ka dërguar në Bashkinë Vorë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 935/6, datë 03.12.2018, protokolluar në Bashkinë Vorë me shkresën nr.4112/18, datë 04.12.2018, ndërsa nga Bashkia Vorë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.4112/19 datë 4.12.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 935/8 datë 17.12.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit

6 mujor.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Vorë 9 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 2 masa, nuk ka masa organizative të pazbatuara dhe janë në proces zbatimi 7 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vorë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën 845,204 lekë. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 845,204 lekë.*

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë 845,204 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.12.2018, janë arkëtuar 176,119 lekë, ndërsa shuma 669,085 lekë edhe pse është nisur njoftimi por nuk është arkëtuar.

1.1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **669,085 lekë** pa tvsh nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5362/1, datë 20.10.2017 me objekt “*Sistemim asfaltim Liqenit, Segmenti Gurrëz, Segmenti Muhajes dhe segmenti Zajza*”, *Njësia Administrative Bërxullë*”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve (trajtuar më hollësisht në faqet 15-17 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

10. BASHKIA MIRDITË

KLSH ka dërguar në Bashkinë Mirditë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 936/7, datë 19.12.2018, protokolluar në Bashkinë Mirditë me shkresën nr. 5650, datë 21.12.2018, ndërsa nga Bashkia Mirditë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 5650/1 datë 01.02.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 936/8 datë 19.02.2019. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Mirditë 13 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 7 masa, dhe nuk janë zbatuar 2 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon: (trajtuar më hollësisht në faqet 8-16 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

1.11.1. Rekomandimi: Bashkia Mirditë të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Mirditë, në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*” i ndryshuar.

2/13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinitorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Mirditë*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **9,881,536 lekë**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 9,881,536**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa me vlerë 9,881,536 lekë, është pranuar e gjithë vlera dhe deri me datë 04.06.2019 janë arkëtuar 98,000 lekë, ndërsa shuma 935,525 lekë nuk është arkëtuar pasi është në proces arkëtimi, shuma 121,488 lekë është bërë njoftimi, shuma 2,465,180 lekë në proces gjyqësor, ndërsa shuma prej 6,261,343 lekë janë njoftuar subjektet për kryerje punimesh por nuk janë paraqitur akt kolaudimet.

2.3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për kompensimin e vlerës prej 922,723 lekë pa TVSH nga OE “A.” shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt “Sistemim-Afaltim rruge Klos-Gjakëz-Domgjon, Nj.A., Fan, Faza I”, Bashkia Mirditë, nëpërmjet realizimit të zërave të punimeve që rezultojnë me diferenca sipas analizës së trajtimit në Raportin Përfundimtar të auditimit duke qenë se ekzistojnë mundësitë fizike objektiviisht.

3.4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për kompensimin e vlerës prej 5,338,620 lekë pa TVSH nga OE “A.” shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt “Zgjatim i unazës së qytetit Rrëshen” Bashkia Mirditë, nëpërmjet realizimit të zërave të punimeve që rezultojnë me diferenca sipas analizës së trajtimit në Raportin Përfundimtar të auditimit duke qenë se ekzistojnë mundësitë fizike objektiviisht.

(trajtuar më hollësisht në faqet 16-20 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

11. BASHKIA SELENICË

KLSH ka dërguar në Bashkinë Selenicë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 934/6, datë 17.12.2018, protokolluar në Bashkinë Selenicë me shkresën nr. 3042/2, datë 20.12.2018, ndërsa nga Bashkia Selenicë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 63, datë 06.01.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 934/7 datë 16.01.2019. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Selenicë 11 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 5 masa, nuk ka masa organizative të pazbatuara dhe janë në proces zbatimi 6 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre *(trajtuar më hollësisht në faqet 9-16 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Selenicë*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **773,849 lekë**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 773,849 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 773,849 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.06.2019, janë arkëtuar 265,167 lekë, ndërsa shuma prej 508,682 lekë nuk është arkëtuar.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH rikërkon zbatimin e procedurave ligjore për shpërbimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e vlerës prej 508,682 lekë.

(trajtuar më hollësisht në faqet 16-20 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

C.2. MASA PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Selenicë për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore si dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhurat e munguara), gjithsej 5 masa, 1 masë është në proces zbatimi (rekomandimi nr.2.1 për të cilin kërkojmë zbatimin plotësisht) dhe 4 masa janë pa zbatuar, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e tyre si më poshtë:

1.1.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore të analizojë situatën e mësipërme dhe të nxjerrë përgjegjësitë. Nga titullari dhe strukturat e tjera përkatëse: Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Zyra Juridike, të marren masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet e pajisur me leje minerare dhe të kërkohet me të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimin e vlerës **582,869,000** lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, sipas aneksit nr. 2/2 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.3.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore për subjektet, në vlerën totale të pa arkëtuar prej **4,462,697** lekë, e ardhur e munguar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

3.4.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për situatën e mësipërme. Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë dhe me vetë punonjësit, të marrë masa për deklarimin e vonuar të punonjësve dhe për pagesën e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Të ndërpriten praktikatat e punësimit të punonjësve me pagë më të ulët se paga minimale dhe mos deklarimit të tyre në organet tatimore.

4.5.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë, zyra e IMTV, për shkeljet e konstatuara nga kundërvajtësit në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, të marrë masa për vendosjen e gjobave në vlerën **8,500,000** lekë, sipas aneksit aneksin nr. 2/5 të bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12. BASHKIA ELBASAN

KLSH ka dërguar në Bashkinë Elbasan rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1176/6, datë 17.12.2018, protokolluar në Bashkinë Elbasan me shkresën nr.6860/18, datë 20.12.2018, ndërsa nga Bashkia Elbasan për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 6860/21 datë 21.12.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1176/7 datë 24.12.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Elbasan 7 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 2 masa, nuk ka masa organizative të pazbatuara dhe janë në proces zbatimi 5 masa, për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre *(trajtuar më hollësisht në faqet 8-14 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar*

Kryetarit të Bashkisë Elbasan, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **2,379,607 lekë**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 2,379,607 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë 2,379,607 lekë, të cilat janë pranuar dhe kanë dalë urdhrat zhdëmtimit Nr.65 datë 16.01.2019 dhe Nr.66 datë 16.01.2019 dhe kontabilizuar e gjithë vlera në momentin e daljes së urdhrat. Janë nisur njoftimet për të dy urdhrat e zhdëmtimit, respektivisht urdhri 65 datë 16.01.2019 i është njoftuar subjektit “E.” sh.p.k me shkresën nr.6860/35-A datë 18.03.2019 dhe urdhri 66 datë 16.01.2019 i është njoftuar subjektit “V.” sh.p.k me shkresën nr.6860 /34-A dhe “M.” sh.p.k me shkresën 6860/35-A datë 18.03.2019, ndërkohë janë hartuar paditë gjyqësore.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH i rikërkon Bashkisë Elbasan zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e plotë të vlerës prej 2,379,607 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet 14-16 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

13.BASHKIA POGRADEC

KLSH ka dërguar në Bashkinë Pogradec rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1078, datë 14.12.2018, protokolluar në Bashkinë Pogradec me shkresën nr.6834/4, datë 24.12.2018, ndërsa nga Bashkia Pogradec për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 227 prot., datë 11.01.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1078/9 datë 16.01.2019. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Pogradec 32 masa organizative, nga të cilat nuk është pranuar 1 masë respektivisht rekomandimi nr. 3.1, janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 12 masa dhe 9 masa organizative nuk janë zbatuar për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 8-25 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

1.3.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të analizojë situatën e krijuar, duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që sektori i auditimit të jetë eficient dhe të zbatojë standardet e auditimit në organizimin dhe funksionimin e saj në të gjitha fazat e procesit të auditimit dhe të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit. Me misionin e saj që të realizojë kryerjen e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe funksionimin si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

2.5.1. Rekomandimi: Të merren masa për organizimin e punës në Drejtorinë ekonomike të Bashkisë (sektorin financiar dhe Drejtorinë e Tatimeve dhe Taksave Vendore, duke mënjanuar veprimet nëpërmjet arkës me lekë në dorë (cash) jashtë limitit ditor prej 1,000 lekë dhe të kryhen vetëm nëpërmjet bankës sipas kërkesave ligjore në fuqi.

3.6.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec (Drejtoria e Financës, DTTV, policia bashkiake dhe IVNMT), të analizojë situatën duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për plotësimin e veprimeve administrative në vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, duke përdorur vula me shënimin “Arka” ose “U arkëtua”, kjo për arsye se mandat arkëtimet me numër serial të trajtohet si

letra me vlerë dhe lëvizja dhe administrimi i tyre të bëhet si letra me vlerë, duke plotësuar kontekstin e veprimit dhe qëllimit të përdorimit të këtij dokumenti.

4.7.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec (Drejtoria e Financës) të marrë masa për plotësimin e veprimeve me anë të bankës me dokumentacionin shoqëruar të pagesave, që të plotësojnë kërkesat e “gjurmës së auditimit” në vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, duke evidentuar përgjegjësitë dhe masat që nevojiten të merren për uljen e riskut abuziv në nivelin më të mundshëm.

5.8.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të analizojë situatën duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që për të gjitha rastet e zbatimit të kontratave të shërbimeve apo blerje mallra, të vlerësojë veçanërisht respektimin e aftit të caktuar dhe për rastet e konstatuara të kryej rilogaritjet dhe të arkëtojë detyrimet e evidentuara për mos respektim afati (penalitetet) të caktuar në kontratë.

6.11.2. Rekomandimi: Nga sektori i Menaxhimit të Aseteve të bashkisë Pogradec, të merren masat e duhura për pronat e njësisve administrative, të cilët me VKM u janë miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim dhe të përgatitet dokumentacioni ligjor sipas kërkesave të VKM nr.500, datë 14.08.2001 i ndryshuar, si dhe (Zyra e kadastrës) të marrë masa për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

7.12.1 Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa për përfundimin e procesit të depozitimit të dokumentacionit ligjorë, në lidhje me transferimin e arkivave dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-komunat.

8.17.1. Rekomandimi: Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës të analizojë të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësisë të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 të nenit 50 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

30.1 Rekomandim: Bashkia Pogradec në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa, duke ju kërkuar mbikëqyrësve dhe operatorëve ekonomik të kontraktuar, plotësimin e dosjes me dokumentacionin teknik ligjor të munguar, që vërteton cilësinë e materialeve të vendosura në objekt, në të kundërt ndaj kontraktorit të aplikohen masa penalizuese sipas përcaktimeve ligjore e kontraktuale.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Pogradec*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **562,463**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 562,463 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 562,463 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera si dhe janë nisur njoftimet për 3 rekomandimet për vlerën 562,463 lekë por ende nuk kanë filluar arkëtimet.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH rikërkon zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e plotë të vlerës prej 562,463 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet 26-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/I. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec.

Nga verifikimi rezulton se deri me datë 27.06.2019 sipas rekomandimeve të KLSH, kanë dalë 4 Vendimet e Gjobave të IMTV për shumën totale prej 650,000 lekë por ende deri me datën e verifikimit nuk kanë filluar procedurat e arkëtimit të vendimeve të gjobave. **KLSH kërkon zbatimin e procedurave ligjore dhe ndjekjen e të gjithave shkallëve të gjykimit për arkëtimin nga 4 personat të gjobës prej 650,000 lekë, si më poshtë:**

1.T. S., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.7, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën 50.000 lekë.

2.E. B., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.10, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën 500.000 lekë.

3.E. N., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.8, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën 50.000 lekë.

4.E. M., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.9, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën 50.000 lekë (trajtuar më hollësisht në faqen 33 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

14.BASHKIA SHIJAK

KLSH ka dërguar në Bashkinë Shijak rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1003/6, datë 21.12.2018, protokolluar në Bashkinë Shijak me shkresën nr.3123/45, datë 26.12.2018, ndërsa nga Bashkia Shijak për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve, me shkresën e saj duke hartuar Planin e Veprimit me shkresën nr.3123/46 datë 16.01.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr.1003/11 datë 18.01.2019. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, ndërkohë ka raportuar në Këshillin Bashkiak ku ka paraqitur “Relacion për Këshillin Bashkiak”, “Monitorimit të Buxhetit të vitit Janar Dhjetor 2018” protokolluar me shkresën nr.1730/7 datë 28/05/2019.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Shijak 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar të gjitha masat, janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar, për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre.

(trajtuar më hollësisht në faqet 9-18 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

1.4.1.Rekomandimi: Të merren masa, të saktësohet përmbajtja e llogarisë 211 “Pyje, kullota plantacione”për vlerën kontabël 4,830,000 lekë me qëllim justifikimin e veprimeve kontabël në vite me dokumentacionin e nevojshëm teknik ligjo dhe nxjerrjen e përgjegjësiive përkatëse për pasqyrimin e saj pa pasur dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

2.5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për verifikimin e gjendjes fizike të aktiveve të qëndrueshme të kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” me qëllim; përcaktimin e statusit juridik të tyre dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor të nevojshme për regjistrimin në pronësi të saj.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 2,082,910 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa me vlerë 2,082,910 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 20.06.2019, janë arkëtuar 1,664.310 lekë, ndërsa shuma 418.600 lekë nuk është arkëtuar.

Sa sipër nuk është zbatuar vetëm rekomandimi nr. 4 masa shpërblim dëmi për të cilën rikërkojmë zbatimin e këtij rekomandimi si më poshtë:

1.4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **418,600 lekë** nga **Operatori Ekonomik “B.” Shpk**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 499, datë 09.02.2017 me objekt “Rehabilitimi i Sistemit Ujitës Njësisë Administrative Gjepalaj”, *Bashkia Shijak*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera (*Trajtuar më hollësisht në faqet 18-20 dhe të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

Referuar parregullsisve dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **4 punonjësve**, për procedurat e prokurimit.

Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr.26, datë 01.04.2019 përcjellë për në Bashkinë Shijak dhe KLSH me shkresën nr.11085/3 datë 01.04.2019, duke vendosur masa dënim me gjobë për 21 persona në vlerën në total prej 3,320,000 lekë , të cilat janë në proces gjyqësor sipas akt padisë datë 21.05.2019.

Rekomandim: -Pas përfundimit të procesit gjyqësor të 21 vendimet e APP për dënimin me gjobë në vlerën **3,320,000 lekë**, të kontabilizohen si debitorë në Pasqyrat Financiare të vitit 2019 dhe të ndiqen si gjithë debitorët e tjerë të Bashkisë, për 21 **persona si më poshtë:**

1.I. Gj., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me detyrë Nën Kryetar i Bashkisë Shijak, është gjobitur në shumën 250,000 lekë.

2.Sh. D., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me detyrë ish-Nën Kryetare e Bashkisë Shijak, është gjobitur në shumën 100,000 lekë.

3.P. A., në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me detyrë Drejtore Ekonomike në Bashkisë Shijak, është gjobitur në shumën 300,000 lekë.

4.J. G., në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkisë Shijak, është gjobitur në shumën 350,000 lekë.

Shtesa nga APP:

1.A. K., ish-Kryetar i Bashkisë Shijak, është gjobitur në shumën 100,000 lekë.

2.E. O., është gjobitur në shumën 350,000 lekë.

3.M. Sh., është gjobitur në shumën 300,000 lekë.

4.D. Ç., është gjobitur në shumën 300,000 lekë.

5.S. H., është gjobitur në shumën 200,000 lekë.

6.R. Sh., është gjobitur në shumën 150,000 lekë.

7.S. H., është gjobitur në shumën 130,000 lekë.

8.H. K., është gjobitur në shumën 120,000 lekë.

9.E. Z., është gjobitur në shumën 100,000 lekë.

10.Gj. Ç., është gjobitur në shumën 100,000 lekë.

11.E. V., është gjobitur në shumën 100,000 lekë.

12.M. Sh., është gjobitur në shumën 80,000 lekë.

13.D. B., është gjobitur në shumën 70,000 lekë.

14.B. T., është gjobitur në shumën 70,000 lekë.

15.F. E., është gjobitur në shumën 50,000 lekë.

16.M. V., është gjobitur në shumën 50,000 lekë.

17.T. P., është gjobitur në shumën 50,000 lekë.

D.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Shijak t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Shijak, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, dhe të vendosë masë administrative “Dënimin me gjobë”, për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudatorë punimesh.**

Nga verifikimi rezulton se deri me datën 20.06.2019 nga Kryeinspektori i IMTV nuk kishin dalë vendimet e gjobave, por pas ndërhyrjes të grupit të auditimit kanë dalë vendimet e dënimit me gjobë, ndërkohë këto 2 vendime nuk janë dërguar nëpërmjet zyrës së protokollit në zyrën e financës dhe nuk janë kontabilizuar dhe për pasojë nuk ka filluar arkëtimi i vlerës prej **600,000 lekë**, për 1 mbikëqyrës të punimeve dhe 1 kolaudator të punimeve si **më poshtë:**

1.G. I. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Pas 6 muajsh me shumë vonesë me vendimin e IMTV nr. 06, datë 24.06.2019, është gjobitur për shumën **100,000 lekë**. Mbikëqyrësi i punimeve ka bërë kërkesë padi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ku kërkon anulimin e gjobës dhe sigurimin e padisë për pezullimin e ekzekutimit të gjobës. Kërkesa për sigurimin e padisë nuk është pranuar nga Gjykata.

2.F. D. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, është gjobitur për shumën **500,000 lekë**. Njoftimi është bërë pas konstatimit nga KLSH dhe konkretisht me shkresën nr. 2162 prot datë 25.06.2019, por në momentin e verifikimit **datën 28.06.2019**, nuk ka filluar arkëtimi i vlerës. Bashkia Shijak ka bërë kërkesë padi drejtuar Gjykatës me nr. 3039 prot., datë 29.08.2019 ku kërkon dënimin me gjobë të kolaudatorit (*trajtuar më hollësisht në faqet 25-27 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve*).

15.KËSHILLI I QARKUT TIRANË

KLSH ka dërguar në Këshillin e Qarkut Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1004/6, datë 17.12.2018, protokolluar në Këshillin e Qarkut Tiranë me shkresën nr.2098/4, datë 19.12.2018, ndërsa nga Këshillin e Qarkut Tiranë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2098/8 prot., datë 08.01.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1004 datë 08.01.2019. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Këshillit të Qarkut Tiranë 12 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 9 masa, janë në proces zbatimi 3 masa për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre (*trajtuar më hollësisht në faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve*).

1.1.1. Rekomandime: Të merren masa nga Titullari i Këshillit të Qarkut Tiranë, për nxjerrjen e urdhrave me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit.

Grupi i Menaxhimit Strategjik në Këshillin e Qarkut Tiranë, të miratojë plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, bazuar në kërkesën e nenit 32 të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

2.4.1. Rekomandimi: Të merren masa për verifikimin e gjendjes fizike të aktiveve të qëndrueshme që administrohen nga Këshilli i Qarkut, me qëllim përcaktimin e statusit juridik të tyre dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor të nevojshme me qëllim regjistrimin e tyre në pronësi të Këshillit të Qarkut.

3.12.1. Rekomandimi: Nga KLSH i është rikërkuar Këshillit të Qarkut Tiranë, ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **737,065 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se deri më datën e verifikimit nuk është arkëtuar asnjë lek, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e plotë të kësaj vlere nga personat s nga punonjësit dhe ish-punonjësit **respektivisht:**

1. **M. K.**, me detyrë Drejtore Juridike Këshilli i Qarkut Tiranë në shumën 61,632 lekë.
2. **E. D.**, me detyrë ish specialiste finance (e larguar) në shumën 251,983 lekë.
3. **E. L.**, me detyrë ish specialiste e politikave sociale (e larguar) në shumën 45,458 lekë.
4. **E. P.**, me detyrë ish specialite arsimit (e larguar) në shumë 48,458 lekë.
5. **K. T.**, me detyrë ish drejtues mjeti (i larguar) në shumën 73,851 lekë.
6. **B. M.**, mbështetës i transportit dhe llogjistikës (i larguar) në shumën 29,589 lekë.
7. **B. S.**, subjekt fizik në shumën 35,914 lekë.
8. **Z.**, subjekt juridik në shumën 48,480 lekë
9. **K.**, subjekt juridik në shumën 81,600 lekë.
10. **E. M.**, me detyrë ish specialiste finance (e larguar) në shumën 20,034 lekë.
11. **G. N.**, ish specialiste e emergjencave civile (e larguar) në shumën 20,033 lekë.
12. **E. S.**, me detyrë ish specialiste e bujqësisë (e larguar) në shumën 20,033 lekë.

16.KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KLSH ka dërguar në Këshillin e Qarkut Shkodër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1153/7, datë 17.12.2018, protokolluar në Këshillin e Qarkut Tiranë me shkresën nr.11494, datë 15.01.2019, ndërsa nga Këshillin e Qarkut Shkodër për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, ndërkohë ka raportuar në Këshillin e Njësisë ku ka paraqitur “Relacion për Këshillin e Qarkut”, protokolluar me shkresën nr.239/1 datë 28/03/2019.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Këshillit të Qarkut Shkodër 6 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre janë zbatuar plotësisht 3 masë, janë në proces zbatimi 3 masa organizative për të KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë: (trajtuar më hollësisht në faqet 7-11 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve)

1.2.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Shkodër, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për parashikimin e shpenzimeve në nivele të realizueshme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **2,564,605 lekë**, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*, dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit të Qarkut, material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite shoqëruar me grafikun për shlyerjen e detyrimeve.

2.3.1-Rekomandim: Këshilli i Qarkut Shkodër, Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat të 7 Vendimeve të gjobave të vendosura në vitin 2014 nga ish INUV i Këshillit Qarkut Shkodër për ndërtimet e pa ligjshme, në vlerën **1,717,237 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”. Njëherazi të marrë masa për llogaritjen e kamat vonesave dhe kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

3.6.1- Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, të rikërkojë përshpejtimin e likuidimit të detyrimeve debitore të 7 (shtatë) punonjësve në vlerën 128,398 lekë duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore.

17.DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA TIRANË

KLSH ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.933/6, datë 19.12.2018, protokolluar në DPTTV me shkresën nr. 203073/51, datë 27.01.2019, ndërsa nga DPTTV për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 12062, datë 05.03.2019. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë 12 masa organizative, nga të cilat nuk janë pranuar 2 masa respektivisht rekomandimi nr. 8.1 dhe 11, (1 masë me fraksion) janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë në proces zbatimi 3 masa për të cilën KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre.

(trajtuar më hollësisht në faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve).

1.7.2. Rekomandimi: DPTTV të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe të aplikojë penalitetet e specifikuar në marrëveshjet respektive të agjentit tatimor.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borxhit tatimor, konstatohet se kemi 47 922 subjekte aktiv (61% të numrit total të subjekteve 78 401), me detyrime në vlerën 4,369,842 mijë lekë, dhe 57% e vlerës së borxhit (**7,649,192 mijë lekë**), pra më shumë se gjysmën e vlerës së detyrimeve e kanë subjektet që ushtrojnë aktivitet, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të Menaxhim Borxhit në arkëtimin e detyrimeve debitorë, në mos zbatim të Kreut XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”.

Në verifikimin e listave të subjekteve debitorë, u konstatua se 3135 subjekte paraqiten me gjendje kreditore prej 24,869 mijë lekë dhe njëkohësisht janë debitorë në vlerën 216,060 mijë lekë dhe nga ana e strukturave (kontabiliteti dhe borxhi) nuk janë marrë masa për saktësimin e detyrimit për këto subjekte (*Më hollësisht trajtuar në pikën (B), faqen 31-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.8.1. Rekomandimi: Drejtoria Operacionale dhe Teknike (*Spektori i Menaxhim Borxhit*) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, në funksion të mbledhjes së detyrimeve të papaguara, dhe nëse pas njoftimeve zyrtare bizneset aktiv nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, të merren masa administrative apo sekuestro sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.

8.1 Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim nuk është pranuar me arsyetimin se procedura e mënyrës së vjeljes me forcë të detyrimit tatimor është parashikuar në Ligjin nr.9920 dt. 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshimet përkatëse dhe në Udhëzimin nr. 24/2008 të MF kallëzimet penale delegohen nga struktura e mbledhjes së borxhit pranë Hetimit Tatimor, strukturë e cila sipas nenit 105 të Ligjit kryen hetimin tatimor, përcakton nëse subjekti ka kryer vepër penale dhe merr masat shtrënguese përkatëse. DPTTV, në strukturën organike nuk ka strukturë të Hetimit Tatimor.

3.11.1. Rekomandimi: Drejtoria Operacionale dhe Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, të evidentojë dhe saktësojë të gjithë subjektet, dhe të dërgojë njoftim vlerësimit tatimore për bizneset të cilat nuk i kanë paguar në masën e duhur detyrimet për taksën e ndërtesës, pavarësisht nëse ndërtesa përdoret si garazh, bodrum, sallon ekspozimi apo shitje mobiliesh, të garazheve të qendrave tregtare, duke aplikuar tarifatat sipas VKB-në nr. 59, dt. 30.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar.

C/1 MASA PËR ELEMENIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË TRAJTIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA TË BASHKISË TIRANË.

Janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim, respektivisht rekomandimi nr. 3, për të cilën rikërkojmë zbatimin e këtij rekomandimi si më poshtë:

1.3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ngrejë një grup punë me specialist të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marrë nga institucionet përgjegjëse (ZVRPP dhe Qarku Tiranë), dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për 5 172 familje me sipërfaqe 12 288 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore, gjithsej për vlerën **64,511,200 lekë**, nga e cila në vitin 2016 për vlerën 31,948,800 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 32,562,400 lekë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë projektvendim ngarkohet Departamenti i Auditivit të Vetëqeverisjes Vendore.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR

ANEKSI NR.1

Për afatin e kthim përgjigjes brenda afatit 20 ditor, për 6 muaj dhe mbi raportimin në Këshillin Bashkiak(Evaduar për periudhën 01.06.2018 deri 31.12.2018)

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Afati 20 ditor i kthim përgjigjes	Afati 6 muajor i raportimit	Mbi raportimin në Këshillin Bashkiak
a	B	1	2	3
1	Bashkia Maliq	Po	Jo	Jo
2	Bashkia Has	Po	Po	Jo
3	Bashkia Gjirokastrë	Po	Jo	Po
4	Bashkia Malësi e Madhe	Po	Jo	Jo
5	Bashkia Memaliaj	Po	Jo	Po
6	Bashkia Përmet	Po	Po	Po
7	Bashkia Dibër	Po	Jo	Jo
8	Bashkia Devoll	Jo	Jo	Jo
9	Bashkia Vorë	Po	Po	
10	Bashkia Mirditë	Po	Jo	Jo
11	Bashkia Selenicë	Po	Jo	Jo
12	Bashkia Elbasan	Po	Jo	Jo
13	Bashkia Pogradec	Po	Jo	Jo
14	Bashkia Shijak	Po	Jo	Po
15	Këshilli i Qarkut Tiranë	Po		
16	Këshilli i Qarkut Shkodër	Jo	Jo	Po
17	DPTTV Tiranë	Po	Jo	
	GJITHSEJT	15	3	5

-Nga auditimi i kontrollit për miratimin e planit për zbatimin e rekomandimeve dhe kthim përgjigjen pranë KLSH brenda afatit 20 ditor, rezultoi se nga 17 subjekte, 2 prej tyre nuk kanë kthyer asnjë përgjigje brenda këtij afati, dhe konkretisht Bashkia Devoll dhe Këshilli i Qarkut Shkdoër.

-Nga auditimi për zbatimin e afatit 6 mujor për raportimin në KLSH, rezultoi se nga 17 subjekte, 14 prej tyre nuk kanë raportuar. Ndërkohë subjekte që kanë raportuar janë Bashkia Has, Bashkia Përmet dhe Bashkia Vorë.

-Nga auditimi për raportimin në Këshillin e Njesisë së Audituar, rezultoi se nga 17 subjekte, 12 prej tyre nuk kanë bërë raport pranë këshillit. Subjekte që kanë bërë raportim janë Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Memaliaj, Bashkia Përmet, Bashkia Shijak dhe Këshilli i Qarkut Shkodër.

Departamenti Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR.2

Masa Organizative: (Evaduar për periudhën 01.06.2018 deri 31.12.2018)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko Manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	B	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Maliq	20		20	8		12	
2	Bashkia Has	13		13	4		5	4
3	Bashkia Gjirokastrë	7		7	3		4	
4	Bashkia Malësi e Madhe	18		18	6		7	5
5	Bashkia Memaliaj	12		12	7		1	4
6	Bashkia Përmet	20		20	11		7	2
7	Bashkia Dibër	13		13	5		7	1
8	Bashkia Devoll	3		3	1		2	
9	Bashkia Vorë	9		9	2		7	
10	Bashkia Mirditë	13		13	4		7	2
11	Bashkia Selenicë	11		11	5		6	
12	Bashkia Elbasan	7		7	2		5	
13	Bashkia Pogradec	32	1	31	11		13	7
14	Bashkia Shijak	14		14	7		4	3
15	Këshilli i Qarkut Tiranë	12		12	9		3	
16	Këshilli i Qarkut Shkodër	6		6	3		3	
17	DPTTV Tiranë	12	2	10	8		2	
	GJITHSEJT	222	3	219	96		95	28

Departamenti Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR.3

Masa Disiplinore: (Evaduar për periudhën 01.06.2018 deri 31.12.2018)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko Manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :				
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar	Nga te cilat janë pranuar e shqyrtuar në Kom Disiplinor
a	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7	8
1	Bashkia Maliq	3		3	3				
2	Bashkia Has	12		12	12				
3	Bashkia Gjirokastrë	24		24	18				6
4	Bashkia Malësi e Madhe	9		9	9				
5	Bashkia Memaliaj	0							
6	Bashkia Përmet	20		20	19			1	
7	Bashkia Dibër	6		6	6				
8	Bashkia Devoll	0							
9	Bashkia Vorë	0							
10	Bashkia Mirditë	0							
11	Bashkia Selenicë	4		4	4				
12	Bashkia Elbasan	0							
13	Bashkia Pogradec	23		23	19		2	2	
14	Bashkia Shijak	13		13	5				8
15	Këshi i Qarkut Tiranë	0							
16	Kësh i Qarkut Shkodër	0							
17	DPTTV Tiranë	15		15	15				
	GJITHSEJT	129		129	112		2	3	14

Departamenti Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR.4

Masa Administrative: (Evaduar për periudhën 01.06.2018 deri 31.12.2018)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko Manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	B	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Maliq	0						
2	Bashkia Has	14		14			9	5
3	Bashkia Gjirokastrë	8		8	7		1	
4	Bashkia Malësi e Madhe	9		9	8		1	
5	Bashkia Memaliaj	3		3	1		2	
6	Bashkia Përmet	0						
7	Bashkia Dibër	17		17			17	
8	Bashkia Devoll	13		13	2		11	
9	Bashkia Vorë	2		2	1		1	
10	Bashkia Mirditë	2		2			2	
11	Bashkia Selenicë	0						
12	Bashkia Elbasan	0						
13	Bashkia Pogradec	4		4			4	
14	Bashkia Shijak	23		23	23			
15	Këshilli i Qarkut Tiranë	0						
16	Këshilli i Qarkut Shkodër	0						
17	DPTTV Tiranë	0						
	GJITHSEJT	95		95	42		48	5

Departamenti Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR.5

- Masa Shpërblim dëmi: (Evaduar për periudhën 01.06.2018 deri 31.12.2018)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko Manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
A	B	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Maliq	3		3		3		
2	Bashkia Has	9		9	3		6	
3	Bashkia Gjirokastrë	16		16			16	
4	Bashkia Malësi e Madhe	3		3		1	2	
5	Bashkia Memaliaj	3		3	2			1
6	Bashkia Përmet	7		7	2		1	4
7	Bashkia Dibër	9		9			9	
8	Bashkia Devoll	2		2			2	
9	Bashkia Vorë	2		2	1		1	
10	Bashkia Mirditë	6		6	2		4	
11	Bashkia Selenicë	5		5	1		4	
12	Bashkia Elbasan	2		2			2	
13	Bashkia Pogradec	3		3			3	
14	Bashkia Shijak	4		4	3		1	
15	Këshilli i Qarkut Tiranë	0						
16	Këshilli i Qarkut Shkodër	0						
17	DPTTV Tiranë	0						
	GJITHSEJT	74		74	14	4	50	5

ANEKSI NR.6

-Masa Shpërblim Dëmi: (Evaduar për periudhën 01.06.2018 deri 31.12.2018)
në 000/ leke

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko Mandu ar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuara :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi dhe proces gjyqësor	Pa zbatuar
A	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Maliq	1,968		1,968			1,968	
2	Bashkia Has	16,717		16,717	1,592		15,125	
3	Bashkia Gjirokastrë	7,158		7,158	115		7,043	
4	Bashkia Malësi e Madhe	3,084		3,084	25		3,059	
5	Bashkia Memaliaj	1,565		1,565	173			1,392
6	Bashkia Përmet	5,355		5,355	644		2,492	2,219
7	Bashkia Dibër	71,835		71,835			71,835	
8	Bashkia Devoll	366		366			366	
9	Bashkia Vorë	845		845	176		669	
10	Bashkia Mirditë	9,881		9,881	98		9783	
11	Bashkia Selenicë	773		773	265		508	
12	Bashkia Elbasan	2,379		2,379			2,379	
13	Bashkia Pogradec	563		563			563	
14	Bashkia Shijak	2,082		2,082	1,664			
15	Këshilli i Qarkut Tiranë	0						
16	Këshilli i Qarkut Shkodër	0						
17	DPTTV Tiranë	0						
	GJITHSEJT	124,571		124,571	4,752		116,208	3,611